

ORGANIZATAT E SHOQËRISË CIVILE DHE ZHVILLIMI I KAPITALIT NJERËZOR

Raporti për Shqipërinë

20/12/2020

PARATHËNIE

Zëri dhe veprimi i Organizatave të Shoqërisë Civile (OSHC) në të mësuarit joformal dhe informal mbështet të rinjtë dhe të rriturit për të pasur akses në të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe për të kontribuar në arritjen e një arsimi cilësor për të gjithë, siç përkthehet nga Objektivi i Zhvillimit të Qëndrueshëm 4 (OZHQ 4).

Si rezultat i pandemisë së Covid-19, OSHC-të po rishikojnë aktivitetet e tyre në fushën e të mësuarit joformal dhe informal dhe mbështetjes së punësimit si një rrugë përpara në realitetin e ri. Zhvillimet e shpejta globale dhe ndërprerjet dhe frenimi i shkaktuar nga Covid-19 i kanë detyruar OSHC-të t'i përshtatin me shpejtësi shërbimet e tyre për t'iu gjendur më afër se kurrë përfituesve vendorë dhe shpesh për t'i bërë këto shërbime edhe më novatore.

Këto janë disa prej konkluzioneve të përgjithshme të anketës së ETF-së mbi përgjigjen ndaj Covid19 nga OSHC-të që veprojnë në fushën e zhvillimit të kapitalit njerëzor (ZHKNJ), veçanërisht përmes të mësuarit joformal dhe informal dhe mbështetjes së punësimit në vitin 2020, duke u bazuar në punën e mëparshme në këtë sektor, duke mbuluar gjashtë vende: Shqipërinë, Jordaninë, Serbinë, Taxhikistanin, Ukrainën dhe Uzbekistanin.

Rezultatet e anketës së ETF-së ushqejnë reflektimin rreth rolit të OSHC-ve si ndërmjetësuese midis autoriteteve publike dhe qytetarëve. Ato japin kontributin përkatës në dialogun e politikave kombëtare dhe lokale si monitoruese, avokate dhe partnere, ndonëse shpeshherë ato thjesht konsultohen, duke pasur efekte të kufizuara në vendimet e politikave. Së bashku, OSHC-të dhe organet institucionale mund të bëjnë më shumë për të promovuar ZHKNJ-në në shoqëritë në ndryshim dhe për të siguruar akses efektiv në procesin e të mësuarit, pa lënë askënd pas.

Objektivi i studimit ishte vlerësimi i kapacitetit operacional të OSHC-ve në fushën e ZHKNJ-së, dhe dinamikës dhe elasticitetit të tyre në kontekstin e krizës pandemike. Për shembull, anketa vlerësoi shkallën e proaktivitetit të OSHC-ve në kushtet e pandemisë krahasuar me natyrën e tyre reaguese, kapacitetin e tyre për të mobilizuar burime (njerëzore, financiare), kontekstin e novacionit dhe parashikimit, kapacitetin organizativ të të mësuarit, komplementaritetin në lidhje me veprimin e qeverive lokale dhe kombëtare, si dhe planet për të ardhmen.

Lidhur me punën e OSHC-ve në fushën e ZHKNJ-së, studimi u fokusua tek:

- Zhvillimi i aftësive nëpërmjet të mësuarit joformal dhe informal të të rinjve dhe të të rriturve;
- Shërbimet e lidhura me punësimin që mbështesin lidhjen mes mësimdhënies dhe punësimit;
- Rritja e ndërgjegjësimit dhe avokimi për zhvillimin e aftësive dhe punësimin;
- Krijimi i njohurive, shfrytëzimi dhe shkëmbimi për zhvillimin e aftësive dhe punësimin

Raporti i Shqipërisë ofron rezultatet e anketës së ETF-së mbi OSHC-të që zbatojnë aktivitetet që lidhen me zhvillimin e kapitalit njerëzor në vend. Ai paraqet një portretizim të OSHC-ve që në Shqipëri që kontribuojnë në fushën e ZHKNJ-së, duke përfshirë sfidat dhe mundësitë me të cilat ato përballen.

Raporti hapet me një prezantim të objektivave të studimit, metodologjisë dhe kuadrit të politikave të vendit për OSHC-të. Kapitulli 1 ofron profilin e OSHC-ve që morën pjesë në këtë anketë. Raporti analizon OSHC-të dhe dialogun e politikave në Kapitullin 3 dhe potencialin për kontributet e tyre të ardhshme në fushën e ZHKNJ-së në Kapitullin 4. Gjetjet e intervistave me një grup të vogël përfituesish të OSHC-ve prezantohen në Kapitullin 5. Në fund, Kapitulli 6 strukturon konkluzionet rreth çështjeve kyçe dhe paraqet disa rekomandime për angazhimin aktual të OSHC-ve, rolit dhe potencialit të tyre në të ardhmen në sektorin e ZHKNJ-së.

Autorja e këtij raporti është Entela Kaleshi, e cila ka kryer anketën në Shqipëri. Koncepti, dizajni dhe metodologjia e anketës është përgjegjësi e ekipit të ETF-së, përkatësisht ekipi i ekspertëve që përbëhet nga Siria Taurelli (koordinatore), Margareta Nikolovska, Stylianos Karagiannis, Ian Cumming, dhe Nadezda Solodjankina. ETF ka përgatitur edhe një përmbledhje të gjetjeve kryesore në të 6 vendet që morën pjesë në anketë për të prezantuar pikat e përbashkëta dhe dallimet mes tyre, të cilat mund të gjenden në *ETF Open Space*. Kjo përmbledhje ka për qëllim të nxjerrë disa përfundime të përgjithshme dhe të mbështesë të mësuarin reciprok, si dhe të krijojë mundësi për një reflektim të përbashkët mbi kushtet që u mundësojnë OSHC-ve të jenë aktive në hartimin, zbatimin, monitorimin dhe vlerësimin e politikave në lidhje me zhvillimin e kapitalit njerëzor.

Deklaratë në lidhje me përgjegjësinë për këtë raport:

Ky raport nuk është redaktuar apo formatuar ende nga ETF-ja. Përveçse nëse përcaktohet ndryshe, ripërdorimi i këtij dokumenti autorizohet përmes licencës së *Creative Commons Attribution 4.0 International* (CC BY 4.0) licence (<https://creativecommons.org/licenses/by/4.0/>). Kjo do të thotë se ripërdorimi lejohet me kusht që të njihet autorësia dhe që çfarëdolloj ndryshimi që t'i bëhet të jetë i përcaktuar. Faktet dhe opinionet e shprehura në këtë raport janë ato të autorit dhe nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht pikëpamjet e ETF-së apo të institucioneve të BE-së.

PËRMBAJTJA

AKRONIMET DHE SHKURTESAT	6
HYRJE	7
KAPITULLI 1 — PROFILI I ORGANIZATËS	8
1.1. Profili i përgjithshëm	8
1.2. Kapacitetet e burimeve njerëzore	10
1.3. Kapacitetet financiare	11
1.4. Mbështetja e OZHQ-ve	12
1.5. Përfituesit e aktiviteteve të OSHC-ve lidhur me zhvillimin e aftësive dhe fushat e mbështetjes	14
KAPITULLI 2 - PËRGJIGJA E OSHC-VE NDAJ EFEKTEVE TË PANDEMISË SË COVID-19 TEK ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE	17
KAPITULLI 3 – AKTORËT DHE DIALOGU NË NIVEL POLITIKASH	20
KAPITULLI 4 - POTENCIALI PËR KONTRIBUTIN E ARDHSHËM NË FUSHËN E ZHKNJ	22
KAPITULLI 5 – PIKËPAMJET E PËRFITUESVE PËR DOBINË E PUNËS SË OSHC-VE	23
KAPITULLI 6– PËRFUNDIME	25
REFERENCAT	28
ANEKS	29
1. Prezenca online e OSHC-ve të anketuara	29

AKRONIMET DHE SHKURTESAT

ETF	Fondacioni Evropian i Trajnimit
OSHC	Organizatat e Shoqërisë Civile
CSOSI	Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve
ZHKNJ	Zhvillimi i Kapitalit Njerëzor
HQ	Selia qendrore
OZHQ	Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm
AFP	Arsimi dhe Formimi Profesional

HYRJE

Ky studim bazohet mbi një anketim që ETF-ja ka kryer në fund të vitit 2020 në Shqipëri, Jordani, Serbi, Taxhikistan, Ukrainë dhe Uzbekistan. Objektivi i kësaj ankete ishte hulumtimi i kontributit të OSHC-ve në Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor (ZHKNJ) në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës dhe në situatën e ndryshueshme të diktuar nga pandemia e COVID-19. Veçanërisht në Shqipëri, studimi u përpoq të kuptonte më mirë vlerën e shtuar të OSHC-ve në ofrimin e qeverisjes shumë-nivelëshe të AFP-së sa i përket të mësuarit informal dhe joformal dhe punësueshmërisë.

Shqipëria po zbaton reforma të ndryshme arsimore që synojnë përmirësimin e kapitalit njerëzor të vendit. Arsimi joformal parashikohet në rregullore të ndryshme ligjore të nxjerra nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Ministria e Ekonomisë dhe Financave dhe Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale¹. Në këtë proces, OSHC-të pritet të luajnë një rol specifik në lidhje me arsimin dhe formimin profesional dhe mundësitë e të mësuarit gjatë gjithë jetës, përveç aktorëve të tjerë të interesuar. Në praktikë, OSHC-të përfshihen gjerësisht në edukimin joformal nëpërmjet ofrimit të programeve për ngritjen e kapaciteteve, shërbimeve dhe kurseve profesionale. Në vitin 2019, më shumë se 319 OSHC kishin licencë dhe ofronin shërbime sociale dhe arsimore. Ky studim paraqet analizën e të dhënave që rezultojnë nga sondazhi i kryer për herë të parë në Shqipëri gjatë muajit nëntor të viti 2020.

Fillimisht u kontaktuan 41 OSHC, të përzgjedhura përmes kanalesh të ndryshme, si përmes organizatave donatore që punojnë në Shqipëri, Agjencisë Shqiptare të Shoqërisë Civile, kontakteve personale të autorit me organizatat që punojnë në këtë fushë, si dhe përmes kërkimit online në bazë të profilit të ofruar nga ETF-ja. Për profilin e OSHC-ve, u morën parasysh këto kritere:

- Organizatat joqeveritare (OJQ) dhe organizatat me bazë komunitetin (OBK) dhe aktorët e tjerë joshëtitërorë
- OSHC-të që veprojnë në fushën e të mësuarit joformal, të mësuarit informal dhe shërbimet e lidhura me punësimin (ZHKNJ).
- Për t'u përfshirë në këtë anketë, OSHC-të duhet të ishin aktive në fushën e ZHKNJ-së, pavarësisht madhësisë së tyre
- Shpërndarja gjeografike

Anketa studioi rolin e OSHC-ve në zhvillimin e aftësive nëpërmjet të mësuarit joformal dhe informal të rinjve dhe të të rriturve; shërbimeve të lidhura me punësimin që mbështesin lidhjen mësim-punësim; rritjen e ndërgjegjësimin dhe avokimit në sektorin e ZHKNJ-së; krijimin, shfrytëzimin dhe shkëmbimin e njohurive në sektorin e ZHKNJ-së; si dhe natyrën plotësuese dhe vlerën e shtuar në krahasim me aktivitetin e qeverisë në të njëjtin sektor.

Bazuar në përgjigjet e dhëna nga 28 OSHC dhe 5 përfitues, ky raport ofron disa informacione të thelluara mbi rolin e OSHC-ve në Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës, në Shqipëri, para dhe gjatë pandemisë së COVID 19. Përveç ofrimit të disa mësimëve të nxjerra dhe rekomandimeve për theksimin e vlerës së shtuar të OSHC-ve në fushën e ZHKNJ-së, ai gjithashtu reflekton mbi sfidat me të cilat përballen OSHC-të lidhur me kapacitetet e tyre dhe angazhimin e tyre me aktorët e tjerë dhe me qeverinë.


¹ Ligji 15/2017 për Arsimin dhe Formimin Profesional në Republikën e Shqipërisë.

Autori i pranon kufizimet e këtij studimi, siç është fakti që të dhënat janë grumbulluar nga intervistat ballë për ballë me përfaqësuesit e OSHC-ve dhe si të tilla ofrojnë perceptimet (subjektive) të personave të intervistuar, jo ndikimin e tyre objektiv.

KAPITULLI 1 — PROFILI I ORGANIZATËS

1.1. Profili i përgjithshëm

Në këtë anketë morën pjesë 28 OSHC². Pjesa më e madhe e OSHC-ve, 71% e tyre, e kishin selinë të vendosur në Tiranë, në kryeqytet, ndërsa pjesa tjetër e kishin selinë në qytete të ndryshme të Shqipërisë, madje të shpërndara gjeografikisht (Grafiku 1). Ishin 7 OSHC që kishin edhe zyra rajonale.



Grafiku 1 - Vendndodhja e zyrave qendrore/selive të OSHC-ve të anketuara në Shqipëri

Sa i përket nivelit të operimit, 93% e OSHC-ve të anketuara punojnë në nivel komuniteti/bazë/lokal, 61% punojnë në nivel kombëtar, kurse 36% veprojnë në nivel nënkombëtar (p.sh. në nivel qarqesh). **Vetëm një organizatë vepron edhe në nivel evropian³.**

Në krahasim me Indeksin e Qëndrueshmërisë së OSHC-ve për vitin 2019 për Shqipërinë (USAID, 2019)⁴, përgjigjet e anketës treguan të njëjtat karakteristika të sektorit të OSHC-ve, por me një kapacitet

²Megjithëse i kufizuar si numër, kampioni prej 28 OSHC-sh konsiderohet si një përgjigje e mirë sa i përket diversitetit të profileve të tyre dhe shpërndarjes gjeografike, si dhe duke pasur parasysh këtë grup të veçantë të synuar, si dhe natyrën tepër teknike të pyetësorit që iu paraqit të anketuarve. Përveç kësaj, studimi nuk ka për qëllim të jetë statistikisht përfaqësues. Bazuar në sa më sipër, autori beson se raporti ka rezultate të vlefshme indikative mbi situatën e OSHC-ve në Shqipëri dhe mbi kontributin e tyre në Zhvillimin e Kapitalit Njerëzor në kontekstin e të mësuarit gjatë gjithë jetës.

³Këto gjetje nga përgjigjet e anketës janë në përputhje me dy raporte të ngjashme për Shqipërinë, përkatësisht me raportin CSOSI për Shqipërinë (f.2), ku thuhet se OSHC-të janë të përqendruara në Tiranë dhe në qendrat kryesore rajonale dhe janë relativisht të rralla në komunat e vogla dhe të mesme dhe në zonat rurale dhe të largëta. Gjithashtu, sipas një raporti të vitit 2019 të Partners Albania for Change and Development (PA), me titull "Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave të OSHC-ve në Shqipëri (Partners Albania for Change and Development, 2019)", 61 përqind e organizatave veprojnë në nivel kombëtar, kurse 42 përqind në nivel lokal.

⁴Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve (CSOSI) për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë, Shqipëri 2019

më të fortë organizativ, pasi ato kanë përfituar më shumë nga programet e mbështetjes së donatorëve. Përveç kësaj, sektori ka përfituar sa i përket infrastrukturës sektoriale nga lançimi i Qendrës Kombëtare Burimore për Shoqërinë Civile në Shqipëri (QBSHC) në vitin 2019. Sidoqoftë, kapaciteti i organizatës dhe qëndrueshmëria e shumicës së OSHC-ve varen nga mbështetja e donatorëve dhe qëndrueshmëria financiare vazhdon të jetë dimension i dobët.

Gjatë vitit 2020, shtatë OSHC të intervistuar kanë koordinuar një rrjet në vend, ndërsa nëntëmbëdhjetë prej tyre kanë marrë pjesë në një ose në më shumë rrjete dhe/ose shoqata. Lista e rrjeteve të intervistuar të OSHC-ve dhe lista e rrjeteve ku kanë marrë pjesë OSHC-të, janë paraqitur në Figurën 2 më poshtë.

Networks CSO Manage	Networks and Association CSO participate
• Albanian businesses and producers in the HORECA sector • Albanian ICT Association • CODEWEEK Albania Robotics Week Albania ROES • Local Youth Network • National Albanian Coalition for Roma Integration in Albania – NACRIA • Nucleus Albania • River Basin Management and Transparency Network	• Albanian Sommelier • Albanian Chefs & Cooks Association • Albanian Food Industry • Albanian National Youth Network European Voluntary Services • Albanian network for European Integration • CSO Network in Vlorë • European Alliance for Apprenticeships • HORECA ALBANIA • ILGA EUROPE & ILGA WORLD ERA • Olof Palme Network in Albania • POP (Perballja e ofertave politike), Kualicioni zgjedhor KRIK Albania • Public Administration Network • Regional Union of Civil Society • Rrjeti i Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore • Tirana Youth Leadership IRIS Network, Balkan Coalition for Social Services Justice for All Coalition • YOUTH VOICE ALBANIA National Youth Congress

Figura 1 - Lista e rrjeteve të menaxhuara nga OSHC-të (majtas) dhe lista e rrjeteve ku OSHC-të kanë marrë pjesë (djathtas)

Mungesa e partneritetit dhe rrjetëzimit ndërsektorial midis OSHC-ve në vend si dhe me rrjetet jashtë vendit është një tjetër nevojë e madhe e identifikuar në këtë sektor.


Këtë e vërteton edhe raporti i vlerësimit të nevojave të OJQ-ve për Shqipërinë për vitin 2019 (Partners Albania for Change and Development, 2019), i cili zbulon se OSHC-të e anketuara u shprehën se partneriteti shihet kryesisht në aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta brenda organizatave me mision dhe fushëveprim të ngjashëm, si dhe në përfitim të njohurive dhe përvojës nga organizatat më të zhvilluara, kryesisht në zonat urbane (veçanërisht në Tiranë). Sipas vlerësimit të kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri 2019 (Partners Albania for Change and Development, 2019), mungesa e aktiviteteve dhe e mbështetjes për rrjetëzimin dhe partneritetet; numri i kufizuar i programeve të shkëmbimit për të mësuar nga modelet e mira dhe praktikat më të mira; vizitat

studimore që mundësojnë avancimin e mëtejshëm të OSHC-ve etj. janë disa nga nevojat e identifikuar nga OSHC-të. Aksesit dhe pjesëmarrja e ulët në rrjetet rajonale dhe evropiane ishte gjithashtu një nevojë që mbetet për t'u adresuar, duke synuar forcimin institucional, mbledhjen e fondeve dhe rritjen e vizibilitetit dhe marrëdhënieve me publikun me aktorë të tjerë⁵.

Lidhur me prezencën e tyre në internet, të gjitha OSHC-të e anketuara pretendonin se kishin një faqe interneti dhe/ose prezencë në mediat sociale. 96% e OSHC-ve të anketuara, pretendonin se kishin profil në Facebook dhe se vepronin përmes tij (90%), kurse 32% e tyre kanë një faqe interneti të dedikuar siç detajohet në Aneksin 1 bashkangjitur këtij studimi⁶. Studimi i AP i vitit 2019 “Vlerësimi i Kapaciteteve dhe Nevojave për OSHC-të në Shqipëri” (Partners Albania for Change and Development, 2019, p. 45) tregon rezultate pothuajse të ngjashme në lidhje me tre kanalet më të përdorura të komunikimit nga organizatat për të informuar publikun dhe për të bashkëvepruar me të, të cilat janë: Facebook (90 përqind); faqet e internetit të organizatave (56.5 përqind); dhe mediat audio-vizuale lokale (55 përqind). Mungesa e prezencës së OSHC-ve përmes faqeve të internetit shpjegohet më tej në Indeks të Qëndrueshmërisë së OSHC-ve të vitit 2019 (USAID, 2019, p. 9), ku thuhet se “... Shumica e OSHC-ve nuk komunikojnë në mënyrë efektive, pasi vetëm një numër i vogël OSHC-sh kanë staf të dedikuar për komunikimin dhe marrëdhëniet me publikun”.

1.2. Kapacitetet e burimeve njerëzore

Kjo anketë hulumtoi edhe kapacitetin e stafit të OSHC-ve dhe pyeti si punonjësit, ashtu edhe bashkëpunëtorët e tyre, duke përfshirë edhe vullnetarët. Grafiku 2 më poshtë jep një pasqyrë të numrit të punonjësve dhe bashkëpunëtorëve me pagë në OSHC-të e anketuara.



Grafiku 2 - Numri i të punësuarve dhe bashkëpunëtorëve me pagë në OSHC-të e anketuara

61% e OSHC-ve të anketuara kanë nga 1 deri në 4 anëtarë stafi dhe bashkëpunëtorë që paguhen dhe vetëm 7% e tyre kanë nga 15 deri në 49. Këto konstatime janë në përputhje me situatën e përgjithshme të personelit në Shqipëri, siç është theksuar në raportin e CSOSI të vitit 2019 për Shqipërinë (USAID, 2019, p. 4), ku thuhet se OSHC-të shqiptare e kanë sfidë mbajtjen e stafit të përhershëm dhe me kohë të plotë, kryesisht sepse janë të kufizuara nga financimi i bazuar tek projektet. Raporti i PA për vitin 2019 (Partners Albania for Change and Development, 2019, p. 11), zbulon gjithashtu se 20 përqind e OSHC-ve për shkak të mungesës së fondeve nuk kishin punonjës me orar të plotë në 2018-ën, kurse 3 përqind

⁵ Vlerësimi i kapaciteteve dhe nevojave të organizatave të shoqërisë civile në Shqipëri për vitin 2019


⁶ Një listë e plotë e prezencës online të OSHC-ve të anketuara jepet në Aneksin 1.

e OSHC-ve nuk kishin as punonjës me kohë të plotë dhe as me kohë të pjesshme dhe mbështeteshin ekskluzivisht tek vullnetarët. Studime të tjera tregojnë se angazhimi vullnetar në Shqipëri mbetet i ulët. Sipas Indeksit Botëror të Dhurimit të Fondacionit të Ndhmës për Bamirësi të vitit 2019 (Charities Aid Foundation, 2019), ishin mesatarisht vetëm 9 përqind e të anketuarve shqiptarë që raportonin se kishin kontribuar si vullnetarë gjatë dhjetë viteve të fundit.

Në përgjithësi, legjislacioni shqiptar në vend as nuk e pengon dhe as nuk e stimulon punësimin në OSHC. Kodi i Punës dhe i gjithë legjislacioni përkatës i trajtojnë të gjithë punonjësit në mënyrë të barabartë, duke përfshirë edhe ata që punojnë për OSHC-të. Në vitin 2019, u miratua Ligji 15/2019, “Për nxitjen e punësimit”⁷. Zbatimi i tij pritet të rrisë nivelin e punësimit, duke ofruar shërbime dhe programe publike për punësim, vetëpunësim dhe kualifikime profesionale.

1.3. Kapacitetet financiare

Në lidhje me mënyrën se si OSHC-të i financojnë aktivitetet e tyre, Grafiku 3 më poshtë ofron një pasqyrë të burimeve kryesore të financimit për OSHC-të e anketuara, shprehur në përqindje.



Grafiku 3 - Burimi kryesor i financimit për OSHC-të shprehur në %

Pothuajse 93% e OSHC-ve të anketuara mbështeten në fondet e donatorëve, kurse disa prej tyre (rreth 46%) mbështeten në fondet e qeverisë dhe ka një përqindje shumë të ulët të OSHC-ve (21.4%) që mbështeten në donacione private. Raporte të tjera mbi statusin e burimeve të financimit të OSHC-ve në Shqipëri tregojnë varësinë e tyre nga fondet e donatorëve. Sipas raportit të CSOSI 2019 për Shqipërinë (USAID, 2019, p. 4), OSHC-të vazhdojnë në 2019-ën të mbështeten në financime nga donatorët ndërkombëtarë, ndërkohë që mbështetja e qeverisë mbetet e ulët. Në përgjithësi, OSHC-të vazhduan të ishin të shqetësuara për shkak të mungesës së fondeve dhe mungesës së diversitetit në modalitetet e financimit dhe veçanërisht OSHC-të më të vogla,

Në përgjithësi, OSHC-ve shqiptare u mungojnë kapacitetet organizative dhe burimet e nevojshme për mobilizim donacionesh nëpërmjet aktiviteteve për mbledhjen e fondeve. Sipas Indeksit Botëror të

⁷ Ligji 15/2019 Për nxitjen e punësimit gjendet në <http://www.parlament.al/Files/ProjektLigje/20190318131036ligj%20nr.%2015,%20dt.%2013.3.2019.pdf>

Dhurimit (Charities Aid Foundation, 2019), mesatarisht 21 përqind e njerëzve në Shqipëri i kanë dhuruar një OSHC-je gjatë dhjetë viteve të fundit. Megjithatë, monitorimi nga PA i aktivitetit filantropik (Partners Albania for Change and Development, 2019) gjatë pesë viteve të fundit tregon një rritje të vazhdueshme të vlerës totale të donacioneve private, ku janë donatorë individualë ata që vazhdimisht japin më shumë se bizneset.

Një sfidë tjetër për OSHC-të mbeten aktivitetet e vetëfinancimit. Vetëm 29% e OSHC-ve të anketuara janë të vetëfinancuara. Indeksi i qëndrueshmërisë së OSHC-ve 2019 për Shqipërinë (USAID, 2019, p. 5) raporton se janë vetëm disa OSHC që angazhohen në ofrimin e shërbimeve si një formë alternative e gjenerimit të të ardhurave. Shërbimet e tyre përfshijnë aftësimin profesional dhe ekspertizën bujqësore, të cilat zakonisht ofrohen me çmime nën ato të tregut.

Sa u përket formave alternative të të ardhurave, vetëm në vitin 2019, OSHC-të në Shqipëri ishin në gjendje të aplikonin për statusin e sipërmarrjeve sociale me pritshmëri të larta për të ardhmen e sipërmarrjes sociale, të nxitur edhe nga zbatimi i Ligjit për Sipërmarrjet Sociale dhe nga shpërndarja e 2.2 milion dollarëve nga qeveria për financimin e sipërmarrjeve sociale gjatë tre viteve të ardhshme. Megjithatë, OSHC-të ishin gjithmonë e më të shqetësuara për trajtimin e tyre nga autoritetet tatimore, qeveritë lokale dhe bankat, të cilat nuk e bëjnë dallimin mes subjekteve jofitimprurëse dhe atyre fitimprurëse. Në këtë drejtim, format alternative të të ardhurave janë ende të paeksploruara nga OSHC-të në Shqipëri deri në përmirësimet e mëtejshme të ligjeve në fuqi.

1.4. Mbështetja e OZHQ-ve

Axhenda për Zhvillim të Qëndrueshëm është dokument i politikave globale i miratuar në vitin 2015 nga Kombet e Bashkuara dhe nga 193 vendet anëtare të OKB-së. Kjo axhendë është një instrument i projektuar me qëllim kapërcimin e çështjeve të ndryshme globale, të cilat janë dinamika afatgjata që komuniteti ndërkombëtar vendosi t'i eliminojë brenda vitit 2030, në mënyrë që t'i hapë rrugën një bote më të barabartë dhe më të qëndrueshme. Ky dokument politikash kërkon një zgjidhje përfundimtare për 17 probleme të gjera që konvertohen pozitivisht në “Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm” dhe, për këtë qëllim, u bën thirrje qeverive dhe shoqërisë civile për pjesëmarrje aktive. Në lidhje me Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm (OZHQ) të Axhendës 2030, UPR-OZHQ Data Explorer (The Danish Institute for Human Rights, 2019) është një mjet i projektuar për të organizuar rekomandime cilësore që vijnë nga organet ndërkombëtare të monitorimit dhe që u drejtohen vendeve në lidhje me sektorë dhe tema specifike të lidhura direkt ose indirekt me të drejtat e njeriut dhe me objektivat e zhvillimit të qëndrueshëm. Ky mjet mund të përdoret nga mbajtësit e të drejtave dhe organizatat e shoqërisë civile për t'i bërë aktivitetet e tyre të lobimit dhe të mbrojtjes më koherente dhe më efektive. Vlerësimi i situatës në Shqipëri në kuadër të këtij mjeti dhe shuma totale e rekomandimeve të drejtuara për këtë vend paraqiten në figurën 3 më poshtë.





Figura 2 - Shqipëria sipas UPR OZHQ

Fushat kryesore të rekomandimeve paraqiten për OZHQ 16 — Paqja, drejtësia dhe institucionet e forta, OZHQ 4 “Edukimi cilësor”, OZHQ 5 “Barazia gjinore”, OZHQ 8 “Puna e denjë dhe rritja ekonomike” dhe OZHQ 10 “Reduktimi i pabarazive”. Këto fusha kërkojnë në të njëjtën kohë mbështetje edhe nga sektori i OSHC-ve.


Në studimin tonë, shumica e OSHC-ve të anketuara mbështesnin OZHQ 5 “Barazia gjinore”, OZHQ 8 “Puna e denjë dhe rritja ekonomike”, dhe OZHQ 10 “Reduktimi i pabarazive”. Numri i OSHC-ve që mbështesnin secilin OZHQ paraqitet në Grafikon 4. Tre OSHC të tjera shtuan edhe OZHQ 12 “Konsumi dhe Prodhimi i Përgjegjshëm” si një fushë tjetër që ato mbështesin. Ky rol specifik i OSHC-ve duhet të hulumtohet, të mbështetet dhe të njihet më tej nga të gjitha palët e interesit.



Grafiku 4 - Numri i OSHC-ve që mbështesin çdo OZHQ

1.5. Përfituesit e aktiviteteve të OSHC-ve lidhur me zhvillimin e aftësive dhe fushat e mbështetjes


Në përputhje me fushat e tyre të mbështetjes zhvillimore, përfituesit e aktiviteteve të OSHC-ve që lidhen me zhvillimin e aftësive nëpërmjet të mësuarit joformal dhe të mësuarit informal, si dhe shërbimet për punësim, ishin të rinjtë, si dhe të rinjtë dhe gratë vulnerabël (Grafiku 5).



Grafiku 5 - Fokusi përfitues i OSHC-ve

Dy grupe të tjera sociale u shtuan në këtë listë të përfituesve dhe përfshinin LGBTI dhe Minoritetet

Grafiku 6 më poshtë jep një pasqyrë të të aktiviteteve të OSHC-ve të anketuara në lidhje me zhvillimin e aftësive nëpërmjet të mësuarit joformal dhe të mësuarit informal dhe shërbimeve për punësim.



Grafiku 6 - Aktivitetet e OSHC-ve që lidhen me zhvillimin e aftësive.

Rezultatet e anketës tregojnë se shumica e OSHC-ve të anketuara i kishin përqendruar aktivitetet e tyre në lidhje me zhvillimin e aftësive tek dhënia dhe forcimi i të mësuarit joformal për të rinjtë dhe për aktivitetet e avokimit. Ato kishin më pak aktivitete të fokusuara tek krijimi dhe/ose përdorimi i informacionit inteligjent për zhvillimin e aftësive dhe/ose punësimin (p.sh. mbledhja e të dhënave cilësore ose sasore, analiza e pavarur e të dhënave, analiza e të dhënave nga burime të ndryshme, formulimi i këshillave për politika etj.)

Ato raportuan se aktivitetet e tjera që lidhen me zhvillimin e aftësive dhe ku ata kishin qenë të përfshirë lidheshin me:

- Edukimin, ndërgjegjësimin dhe avokimin për promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe vullnetarizmit
- Promovimin e Aftësive dhe Platformave për Zhvillim përmes organizimit të Konkurseve Kombëtare të Aftësive në baza vjetore në Shqipëri

Gjetjet nga anketimi janë në përputhje edhe me studime të tjera në Shqipëri siç është Raporti i Anketës për Arsimin e të Rriturve në Shqipëri⁸, (INSTAT, 2017) i cili vë në dukje se 67.8% e popullsisë së moshës 25-64 vjeç kanë marrë pjesë në të mësuarit informal dhe 74% e tyre janë të rinj në moshë (25-34). Raporti i CSOSI për Shqipërinë 2019 (USAID, 2019) gjithashtu vëren se avokacia e OSHC-ve ka vazhduar të jetë e fortë gjatë vitit 2019, pavarësisht sfidave të vazhdueshme, OSHC-të angazhohen aktivisht në proceset e vendimmarrjes dhe politikëbërjes në nivel lokal dhe kombëtar. I njëjti raport (USAID, 2019) tregon se në përgjithësi, OSHC-të në nivel kombëtar vazhdojnë të kenë kapacitete më të forta avokimi dhe lobimi sesa OSHC-të në nivel lokal.

Kur u pyetën në lidhje me **përmbajtjen e aktiviteteve të OSHC-ve** lidhur me zhvillimin e aftësive nëpërmjet të mësuarit joformal dhe të mësuarit informal, si dhe me shërbimet e punësimit, 75% e OSHC-ve të anketuara u shprehën se kanë ofruar mbështetje për zhvillimin e kompetencave teknike (p.sh. aftësitë profesionale, aftësitë teknike, aftësitë dixhitale, aftësitë e tjera të lidhura me punën etj.), kurse dhe 60% siguroi mbështetje me Kompetencat kryesore (p.sh. të mësosh si të mësosh, puna në ekip, lidhshipi, komunikimi, gjuhët, e folura në publik, vetëbesimi, sipërmarrja etj.) dhe ishin më pak të

⁸Anketa e vitit 2017 për Arsimin e të Rriturve në Shqipëri, INSTAT


përfshira në marrëdhëniet me autoritetet dhe sektorin publik (21%) dhe me mbështetjen dhe zhvillimin e ndërmarrjeve mikro dhe të vogla (10%).

85% e OSHC-ve të anketuara deklaruan se **publikojnë analizën e tyre**, publikime dhe hulumtime në kanalet e tyre online të komunikimit si website, Facebook ose Instagram dhe se janë të gatshme t'i ndajnë rezultatet me rrjetet dhe palët e interesit.

Lidhur me **Mënyrat më të Efektshme të zbatimit të aktiviteteve** që lidhen me zhvillimin e aftësive përmes të mësuarit joformal dhe të mësuarit informal, si dhe për shërbimet e punësimit, OSHC-të vunë në dukje mënyrat e mëposhtme efektive (Grafiku 7).

- Kurse trajnimi joformale
- Mbështetja e të mësuarit joformal të njerëzve përmes kolegëve, të mësuarit autodidakt, etj.
- Stilet e trajnimit/të mësuarit që mbështeten tek angazhimi dhe pjesëmarrja
- Sigurimi i motivimit të njerëzve për të mësuar
- Përdorimi i një kombinimi mjesh ndihmëse tradicionale dhe dixhitale trajnimi

Është e rëndësishme të theksohet se këto mënyra efektive të zbatimit të aktiviteteve ishin në përputhje edhe me aktivitetet ku fokusoheshin OSHC-të e anketuara.



Grafiku 7 - Mënyrat efektive të zbatimit të aktiviteteve


Shumica e të anketuarve nga OSHC-të e anketuara, u shprehën se u dukeshin **mënyra shumë efektive të të mësuarit** të mësuarit në klasë, në qendra trajnimi, në qendrat këshilluese ose në mjedise të tjera të ngjashme të të mësuarit (89%), si dhe të mësuarit gjatë punës (64%), pasuar nga vendet informale (46%), ndërkohë që të mësuarit online dhe në shtëpi ishin më pak të preferuarat ose konsideroheshin më pak efektivet.

KAPITULLI 2 - PËRGJIGJA E OSHC-VE NDAJ EFEKTEVE TË PANDEMISË SË COVID-19 TEK ZHVILLIMI I BURIMEVE NJERËZORE

Pyetjet e trajtuara në këtë seksion kanë të bëjnë me ndryshimet në grupet dhe aktivitetet përfituese të OSHC-ve në vitin 2020 për shkak të pandemisë COVID19.

Është e rëndësishme të theksohet se në përgjithësi situata e jashtëzakonshme e COVID 19 solli shumë pasiguri për popullatën lidhur me stabilitetin e tyre ekonomik dhe çështjet sociale. Edhe sektorit të OSHC-ve iu desh të përballej me këto pasiguri, nëse do t'i pezullonin apo jo aktivitetet e planifikuara, si të vepronin në kushtet e distancimit social dhe çfarë të ndryshonin në strategjitë e tyre për zbatimin e aktiviteteve dhe në komunikimin me përfituesit e tyre të synuar, duke ua bërë mjaft të vështira për ca kohë operacionet dhe vendimmarrjet.

Vetëm shtatë (7) prej OSHC-ve të anketuara u shprehën se i kishin ndryshuar **grupet përfituese të aktiviteteve të tyre për ZHKNJ-në gjatë pandemisë COVID19** në vitin 2020 dhe se në këto raste vendimi ishte marrë bazuar në rekomandimin e organeve ndërmjetëse dhe në vlerësimet e vetë OSHC-ve (Grafiku 8).




Grafiku 8 - Arsytet e OSHC-ve për ndryshimin e grupeve të tyre përfituese

Pyetjes nëse OSHC-të e anketuara i kishin ndryshuar prioritetet lidhur me aktivitetet e tyre për ZHKNJ gjatë pandemisë së COVID19, vetëm 4 OSHC iu përgjigjën se i kishin ndryshuar, 21 OSHC i kishin ndryshuar deri diku, kurse vetëm 3 OSHC nuk i kishin ndryshuar prioritetet.

Ato OSHC që i kishin ndryshuar aktivitetet e tyre për ZHKNJ gjatë pandemisë së COVID19 në vitin 2020 krahasuar me vitet e mëparshme, (duke përfshirë edhe ato që i kishin ndryshuar deri diku), raportuan se kishin punuar më shumë për të ofruar mësim joformal për të rinjtë, për të forcuar të

mësuarit informal të të rinjve (p.sh. të mësuarit nga kolegët, të mësuarit autodidakt, të mësuarit nga përvoja e vet, etj.) dhe kishin punuar më shumë për avokimin për të rinjtë. Në përputhje me këto, anketa konstatoi një rritje të aktivitetëve të reja në të njëjtat fusha. Grafiku 9 më poshtë tregon gjithashtu se në cilat fusha OSHC-të i kishin pezulluar aktivitetet dhe duket se janë ndërmarrë më pak veprime ose se në përgjithësi janë anuluar disa aktivitete mbi avokimin në mbrojtje të komunitetit/grupeve të caktuara/sectorëve, avokimit për të rriturit dhe për të forcuar mësimin informal të të rinjve.




Grafiku 9 - Ndryshimet e aktivitetit të OSHC-ve të bëra gjatë pandemisë së COVID19 në vitin 2020 krahasuar me vitet e mëparshme

Siç do të shohim në gjetjet e mëposhtme (Grafiku 10), disa nga këto aktivitete mund të ndikohen edhe nga përdorimi i teknologjisë së grupit të synuar të përfituesve të OSHC-ve për shkak të distancimit social dhe protokolleve kufizuese të vendosura nga qeveria.


89% e të anketuarve raportuan se kanë përdorur më shumë mjete të mësimit dixhital gjatë pandemisë COVID19 në vitin 2020, krahasuar me vitet e mëparshme. Programet kompjuterike që mundësojnë klasa virtuale (p.sh. Ms Teams, Google Classroom, Moodle), mjetet sinkrone të video-komunikimit (p.sh. Zoom, Skype, WhatsApp, Facebook live) dhe mediat sociale (p.sh. grupet në Facebook, kanalet në YouTube ishin mjetet e përdorura më shumë prej tyre në krahasim me vitet e mëparshme (Grafiku 10)

Use of DIGITAL LEARNING tools during the COVID19 pandemic in 2020, compared to previous years



Grafiku 10 - Përdorimi i mjeteve të të mësuarit dixhital nga OSHC-të gjatë Pandemisë së Covid19 në vitin 2020

96% e OSHC-ve të anketuara raportuan se kanë nxjerrë disa mësimet në planin afatshkurtër, në rastet e emergjencave ose në kushtet e të punuarit nën presion (Grafiku 11), kurse 89% e tyre kanë nxjerrë mësimet afatgjatë (Grafiku 12)



Grafiku 11 - Mësime afatshkurtra të nxjerra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme



Grafiku 12 - Mësimet afatgjata të nxjerra gjatë gjendjes së jashtëzakonshme

Të dyja rezultatet nga mësimet e nxjerra tregojnë qëndresën e OSHC-ve gjatë krizës pandemike të COVID 19. Në masë të madhe, mësimet afatshkurtra të nxjerra përfshijnë:

- Përshtatjen e mënyrave të zbatimit ose metodave të aktiviteteve
- Vlerësimin e nevojave të reja
- Ofrimin e shërbimeve të reja
- Mobilizimin e burimeve të reja, njerëzore dhe/ose financiare dhe/ose fizike

Kurse mësimet strategjike që kanë nxjerrë përgjithësisht OSHC-të nga zbatimi i aktiviteteve në fushën e ZHKNJ në përgjigje të krizës së pandemisë së COVID19 në vitin 2020 përfshijnë:

- Nevojën për te qenë novator me shërbimet ekzistuese & rivendosjen e prioritetëve mes shërbimeve ekzistuese
- Ofrimin e shërbimeve të reja
- Ritrajnimin e anëtarët të stafit dhe/ose vullnetarëve dhe
- Thithjen e fondeve shtesë
- Bashkëpunimin me organizatat e tjera
- Përmirësimin e aftësive organizative
- Rritjen e ekspertizës së vet

KAPITULLI 3 – AKTORËT DHE DIALOGU NË NIVEL POLITIKASH

Nga OSHC-të e përfshira në këtë anketë, **21.4% u shprehën se kishin qenë të përfshira** në dialogun për politikën në lidhje me të mësuarin joformal, të mësuarin informal dhe punësimin. **42.9 % e tyre kishin qenë të përfshira në këtë dialog me raste, kurse 35.7 nuk kishin qenë të përfshira**, por do të kishin dashur të merrnin pjesë në dialogun mbi politikën.

Çështja e mospërfshirjes së OSHC-ve në dialogun mbi politikën konstatohet edhe në shumë studime të tjera në Shqipëri. Matrica e monitorimit për një mjedis favorizues për zhvillimin e shoqërisë civile, Raporti kombëtar: Shqipëria (Partners Albania for Change and Development,

2019, p. 43) tregon se nga OSHC-të e anketuara, 34% e tyre kanë marrë pjesë në punën e grupeve dhe komisioneve këshilluese, konsultuese ose në grupet e punës. Në të njëjtin raport theksohet se një nga shqetësimet kryesore të OSHC-ve në lidhje me pjesëmarrjen e tyre në konsultimet publike mbetet mungesa e besimit nëse komentet/kontributet e tyre do të merren apo jo parasysh nga institucionet publike (Partners Albania for Change and Development, 2019).

OSHC-të e anketuara raportuan se ato kishin qenë më të përfshira me aktorët e mëposhtëm.

- 83.6% me ofruesit e shërbimeve të arsimit dhe trajnimit
- 61.1% me forumet e platformave të OSHC-ve
- 55.6 % me institucionet qeveritare
- 55.6 % me Shërbimin Kombëtar të Punësimit

Konstatimet se shumica e OSHC-ve të anketuara kishin qenë më shpesh të përfshira me ofruesit e arsimit dhe trajnimit konfirmon edhe gjetjet e mësipërme. Ky informacion lidhet edhe me arsyet se pse OSHC-të kanë qenë të influencuara për të ndryshuar grupet e tyre përfituese në bazë të rekomandimeve të organeve ndërmjetëse (Shih Kapitullin2, fq. 14)

35.7 % e OSHC-ve u shprehën se kishin qenë **sistematikisht të lidhura apo kishin raportuar tek një prej aktorëve të mësipërm**, 25 % me raste, **kurse 39.3 % raportuan se nuk kishin qenë të lidhura me këta aktorë**, por do të kishin dashur ta kishin pasur këtë lloj lidhjeje apo raportimi. Nga OSHC-të që raportuan se kishin qenë sistematikisht të lidhura me aktorët e mësipërm, përmbajtja kryesore e lidhjes/raportimit ishte për qëllime monitorimi dhe raportimi (Grafiku 13).



Grafiku 13 – Qëllimi i lidhjeve të OSHC-ve me aktorët e ndryshëm


OSHC-të e përshkruan rolin e tyre me aktorët e ndryshëm si plotësues (19 OSHC); këshillues (6 OSHC); bashkëpunues (11 OSHC); dhe alternativ (4 OSHC), ndërsa 11 OSHC u shprehën se ishin të ndryshme (ne nuk e informojmë qeverinë dhe as qeveria nuk na informon neve), kurse 1 OSHC u ndje jo në të njëjtën linjë (në kundërshtim me politikën dhe masat e qeverisë).

KAPITULLI 4 - POTENCIALI PËR KONTRIBUTIN E ARDHSHËM NË FUSHËN E ZHKNJ

Ky seksion hulumtoi informacionet mbi avantazhet e perceptuara të OSHC-ve, si dhe kontributin e mundshëm në të ardhmen në sektorin ZHKNJ.

Sa u përket **avantazheve kryesore të OSHC-ve krahasuar me aktorët e tjerë (publikë, privatë, joqeveritarë), organizatat e intervistuar identifikuuan këto fusha (Grafiku 14):**

- 75% u shprehën se mbështesnin efikasitetin e proceseve të arsimit, trajnimit dhe proceseve të tjera të të mësuarit
- 64.3% u shprehën për përmirësimin e rezultateve të dialogut politik dhe konsultimeve publike
- 42.90% u shprehën se kishin identifikuar nevojat e grupeve të ndryshme në sistemin formal të të mësuarit dhe punësimit dhe se ato sillnin zërin e tyre në dialogun në nivel politikash



Grafiku 14- Avantazhi i OSHC-ve krahasuar me organizatat e tjera

Nëse OSHC-të e anketuara **planifikonin ta forconin kontributin e tyre në fushën e ZHKNJ**

- 53.6% e OSHC-ve thanë se planifikonin ta forconin këtë kontribut,
- 42.9 % thanë se kanë në plan ta bëjnë këtë deri diku
- 3.6 % u përgjigjën JO, kushtet nuk e favorizonin një ndryshim të tillë.

Sa u përket fushave kryesore ku OSHC-të kishin shumë gjasa ose kishin gjasa ta forconin kontributin e tyre për ZHKNJ, anketa konstatoi këto fusha:

Për 100% të tyre

- Aksesueshmëria në të mësuarit formal, joformal dhe informal
- Gjithëpërfshirje e mundësive të të mësuarit (pavarësisht moshës, gjinisë, aftësive, shtetësisë, vulnerabilitetit, statusit të punësimit, etj.)
- Cilësia e mundësive të të mësuarit

Për 92.6%

- Nevojat e individëve për të mësuar dhe për t'u punësuar
- Nevojat e komuniteteve lokale për të mësuar dhe për t'u punësuar

77.8% Vetëpunësimi dhe sipërmarrja

70.4% - Ofrimi dhe nxitja e kompetencave teknike

74.1% Jetesa e qëndrueshme dhe ekonomia e gjelbër

63% E ardhmja e të mësuarit dhe pilotimi i novacioneve në fushën e të mësuarit

60% - Ofrimi dhe nxitja e kompetencave gjithëpërfshkuese

Fushat e konsideruara më pak ishin

- 59.3% - Krijimi i njohurive, mbledhja dhe analizimi i dhënave, monitorimi dhe vlerësimi i pavarur i sektorit të ZHKNJ, këshillimi për politikën
- 44% E ardhmja e punës dhe pilotimi i novacioneve në punë
- 23%- Shoqëria dhe ekonomia dixhitale

KAPITULLI 5 – PIKËPAMJET E PËRFITUESVE PËR DOBINË E PUNËS SË OSHC-VE

U kontaktuan pesë përfitues të OSHC-ve në vijim për të parë pikëpamjet e tyre për dobinë e punës së OSHC-ve për ZHKNJ.

- SHUM Albania – Shoqata për Ushqim dhe Mirëqenie
- ICLA – Instituti për Ndryshim dhe Liderhip në Shqipëri
- VYC – Qendra Rinore e Vlorës
- ËID – Gratë në Zhvillim, Korçë
- NCCS – Qendra Kombëtare për Shërbimet Komunitare

Sa i përket demografisë së të anketuarve; personat e intervistuar ishin katër gra dhe një burrë, tre prej tyre nga zonat rurale dhe dy nga qytetet (Vlora dhe Tirana)

Përfituesit u shprehën se e konsideronin të mësuarin mes kolegësh, diskutimet për problemet praktike, sesionet interaktive dhe shembujt konkretë; si dhe punën praktike si diçka që u pëlqente vërtet në **trajnimet dhe mbështetjen që ata kishin marrë**. Përveç kësaj, ata u shprehën se kjo mbështetje i kishte ndihmuar që të kishin perspektiva të reja në lidhje me zhvillimin e aftësive të tyre dhe mundësive për karrierë.

Kërkesat e shprehura nga përfituesit për përmirësimin e trajnimit dhe të mbështetjes së ofruar nga OSHC-të përfshinin ofrimin e lidhjeve dhe ekspozimin ndaj zyrave lokale të punësimit dhe ofruesve të bizneseve. Një tjetër mbështetje që ata kërkonin ishte akses në mbështetje financiare në rastin e hapjes së bizneseve të reja.

Gjatë procesit të mbështetjes dhe të trajnimit, të anketuarit u shprehën se kishin disa mendime dhe njohuri që mund t'i ndihmonin për të zhvilluar aftësitë apo mundësitë e punësimit si ato që lidhen me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, duke theksuar nevojën për mbështetje në përdorimin e mjeteve të të mësuarit dixhital. Përveç kësaj, disa trajnime dhe shërbime mund të kishin qenë më të mira nëse do të ishin kombinuar format e ndryshme të të mësuarit dhe të trajnimit, duke përfshirë trajnimet formale, joformale dhe trajnimet në kushte pune.

Sa i përket trajnimit dhe mbështetjes vijuese, përfituesit, ndonëse dy prej tyre e konsideronin mundësinë për punë dhe të ardhurat ekonomike si aktivitetin më të rëndësishëm, dhanë disa propozime konkrete në lidhje me të mësuarin e vazhdueshëm dhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve si:

- *Të mësuarit social – lidhur me përdorimin e mjeteve dixhitale, të mësuarit nga bashkëmoshatarët dhe kolegët, sidomos sa u përket aftësive të buta (soft skills) dhe shkëmbimit të përdorimit të përvojave praktike dhe shembujve realë*
- *Trajnimet gjatë praktikave profesionale – përfitim i përvojave të veçanta lidhur me njohuritë teknike, aftësitë në mjedisin e punës dhe përfitim të ideve të reja për testimin e hapjes së një biznesi*
- *Ndjekjen e trajnimeve formale të arsimit profesional në fusha specifike*

Kur u pyetën se si u dukeshin informacionet për trajnimet dhe aktivitetet mbështetëse të OSHC-ve, përfituesit u shprehën për mënyra të ndryshme të ofrimit të tyre si informimi nga miqtë, mediat sociale dhe interneti, si dhe kontaktimet e drejtpërdrejta nga organizata apo referimet nga Zyra e Punës në bashkitë përkatëse.

Përfituesit u shprehën se ishin përgjithësisht të kënaqur me mënyrën se si trajnerët dhe këshilluesit i trajtonin nevojat e tyre specifike, duke përdorur një sërë metodash, si aktivitetet e organizuara individuale apo në grupe për adresimin e nevojave dhe interesave individuale apo të grupeve të caktuara, duke përdorur një vlerësim paraprak të grupeve apo përmes ofrimit të ushtrimeve apo aktiviteteve individuale apo në shtëpi për individët me këshillime dhe orientime specifike për interesat e tyre individuale.

Të gjithë përfituesit e anketuar u shprehën se u ishte dhënë mundësia të vlerësonin dhe/ose të ofronin një lloj feedback-u për cilësinë ose dobinë e shërbimeve të ofruara mes formave të ndryshme të vlerësimit formal në fund të trajnimeve në klasë apo trajnimeve online. Aktivitetet e rishikimit si grup dhe ndonjëherë procesi i vlerësimit pas një aktiviteti të mësuarit gjatë ditës për atë çka ishte mësimi më i rëndësishëm që kishin marrë pjesëmarrësit gjatë aktivitetit konsiderohej prej tyre si aktivitet shumë i rëndësishëm, sepse u jepte mundësi pjesëmarrësve të adresonin shpejt nevojat e tyre dhe që trajnerët të reflektonin për ato nevoja në sesionet e mëvonshme.

Të gjithë përfituesit u shprehën se do të ishin të gatshëm t'u këshillonin miqve të ngushtë ose të afërme të ndiqnin të njëjtat trajnime/mbështetje/orientime – për shkak të arsyeve të mëposhtme personale.

- *Më kanë dhënë informacione të thelluara për rrugë të reja karriere,*
- *Kam mësuar aftësi të reja dhe jam njohur me kolegë të tjerë*
- *Përmbajtja dhe metodologjia ishin relevante për nevojat e mia*
- *Trajnimi më ka ndihmuar që të aplikoj për një punë të re në sektorin e kulinarisë*

KAPITULLI 6– PËRFUNDIME

Sa i përket demografisë së të anketuarve; ishin katër gra dhe një burrë, tre prej tyre nga zonat rurale dhe dy nga qytetet (Vlora dhe Tirana)

Përfituesit e konsideronin të mësuarin mes kolegësh, diskutimet për problemet praktike, sesionet interaktive dhe shembujt konkretë; si dhe punën praktike si diçka që u pëlqente vërtet në **trajnimet dhe mbështetjen që ata kishin marrë**. Përveç kësaj, ata u shprehën se kjo mbështetje i kishte ndihmuar që të kishin perspektiva të reja në lidhje me zhvillimin e aftësive të tyre dhe mundësive për karrierë.

Kërkesat e shprehura nga përfituesit për përmirësimin e trajnimit dhe të mbështetjes së ofruar nga OSHC-të përfshinin ofrimin e lidhjeve dhe ekspozimin ndaj zyrave lokale të punësimit dhe ofruesve të bizneseve. Një tjetër mbështetje që ata kërkonin ishte aksesin në mbështetje financiare në rastin e hapjes së bizneseve të reja.

Gjatë procesit të mbështetjes dhe të trajnimit, të anketuarit u shprehën se kishin disa mendime dhe njohuri që mund t'i ndihmonin për të zhvilluar aftësitë apo mundësi punësimi si ato që lidhen me pandeminë e shkaktuar nga COVID-19, duke theksuar nevojën për mbështetje në përdorimin e mjeteve të të mësuarit dixhital. Përveç kësaj, disa trajnime dhe shërbime mund të kishin qenë më të mira në kombinim me format e tjera të të mësuarit, si me ofrimin e trajnimeve formale, joformale dhe trajnimeve në kushte pune.

Sa i përket trajnimit dhe mbështetjes vijuese, përfituesit, ndonëse dy prej tyre e konsideronin mundësinë për punë dhe të ardhurat ekonomike si aktivitetin më të rëndësishëm, dhanë disa propozime konkrete në lidhje me të mësuarin e vazhdueshëm dhe aktivitetet për rritjen e kapaciteteve si:

- *Të mësuarit social – lidhur me përdorimin e mjeteve dixhitale, të mësuarit nga bashkëmoshatarët dhe kolegët, sidomos sa u përket aftësive të buta (soft skills) dhe shkëmbimit të përdorimit të përvojave praktike dhe shembujve realë*
- *Trajnimet gjatë praktikave profesionale – përfitim i përvojave të veçanta lidhur me njohuritë teknike, aftësitë në mjedisin e punës dhe përfitimin e ideve të reja për testimin e hapjes së një biznesi*
- *Ndjekja e trajnimeve formale të arsimit profesional në fusha specifike*

Kur u pyetën rreth informimit për trajnimet dhe aktivitetet mbështetëse të OSHC-ve, përfituesit u shprehën për mënyra të ndryshme të informimit, si nga miqtë, mediat sociale dhe interneti, si dhe nga kontaktimet e drejtpërdrejta nga organizatat apo referimet nga Zyra e Punës në bashkitë përkatëse.

Përfituesit u shprehën se ishin përgjithësisht të kënaqur me mënyrën se si trajnerët dhe këshilluesit i trajtonin nevojat e tyre specifike, duke përdorur një sërë metodash, si aktivitetet e organizuara individuale apo në grupe për adresimin e nevojave dhe interesave individuale apo të grupeve të caktuara, duke përdorur një vlerësim paraprak të grupeve apo përmes ofrimit të ushtrimeve apo aktiviteteve individuale ose aktiviteteve në shtëpi përmes këshillimeve dhe orientimeve specifike për interesat e tyre individuale.

Të gjithë përfituesit e anketuar u shprehën se u ishte dhënë mundësia të vlerësonin dhe/ose të ofronin një lloj *feedback*-u për cilësinë ose dobinë e shërbimeve të ofruara mes formave të ndryshme të vlerësimit formal në fund të trajnimeve në klasë ose trajnimeve online. Aktivitetet e rishikimit si grup dhe ndonjëherë procesi i vlerësimit pas një aktiviteti të mësuarit gjatë ditës për atë çka ishte mësimi më i rëndësishëm që kishin marrë pjesëmarrësit gjatë aktivitetit konsiderohej prej tyre si aktivitet shumë i

rëndësishëm, sepse u jepte mundësi pjesëmarrësve të adresonin shpejt nevojat e tyre dhe që trajnerët të reflektonin për ato nevoja në sesionet e mëvonshme.

Të gjithë përfituesit u shprehën në mbështetje të këshillimit të miqve të ngushtë apo të afërme për të ndjekur të njëjtat trajnime/mbështetje/orientime – për shkak të arsyeve të mëposhtme personale.

- *Më kanë dhënë informacione të thelluara për rrugë të reja karriere,*
- *Kam mësuar aftësi të reja dhe jam njohur me kolegë të tjerë*
- *Përmbajtja dhe metodologjia ishin relevante për nevojat e mia*
- *Trajnimi më ka ndihmuar që të aplikoj për një punë të re në sektorin e kulinarisë*

Në lidhje me rolin që OSHC-të kanë luajtur në fushën e të mësuarit joformal dhe informal dhe shërbimeve të punësimit, përfituesit e aktiviteteve të OSHC-ve në lidhje me zhvillimin e aftësive përmes të mësuarit joformal dhe informal dhe shërbimeve të punësimit ishin të rinjtë, të rinjtë dhe gratë vulnerabël. OSHC-të i kanë fokusuar **aktivitetet e tyre në lidhje me zhvillimin e aftësive tek ofrimi dhe forcimi i të mësuarit joformal për të rinjtë dhe tek aktivitetet e avokacisë.** Ato kanë pasur më pak aktivitete të fokusuara tek krijimi dhe/ose përdorimi i informacioneve inteligjente për zhvillimin e aftësive dhe/ose për punësimin (p.sh. mbledhja e të dhënave cilësore ose sasiore, analizimi i pavarur i të dhënave, analizimi i të dhënave nga burime të ndryshme, ofrimi i këshillimeve për politika të ndryshme, etj.)

OSHC-të raportuan se kishin qenë më të përfshira në fushën e (a) arsimit, ndërgjegjësimit dhe avokacisë për promovimin e të drejtave të njeriut, demokracisë dhe vullnetarizmit dhe në (b) nxitjen e aftësive, pasi **aktivitetet e tyre lidheshin me zhvillimin e aftësive.**

Sa i përket **përmbajtjes së aktiviteteve të OSHC-ve** në lidhje me zhvillimin e aftësive, 75% e OSHC-ve të anketuara kishin ofruar mbështetje për **kompetencat teknike** (aftësi profesionale, aftësi teknike, atësi dixhitale dhe aftësi të tjera të lidhura me punën, etj.), kurse 60% kishin ofruar mbështetje për **kompetencat kryesore** (të mësuarin për të mësuar aftësi të reja, për punën në ekip, leadershipin, komunikimin, gjuhët e huaja, të folurin në publik, vetëbesimin, aftësitë sipërmarrëse, etj.). **Ato kishin qenë më pak të angazhuara në bashkëpunimin me autoritetet dhe me sektorin publik** dhe në mbështetjen e zhvillimeve të bazuara tek sipërmarrjet mikro dhe të vogla. Në këtë aspekt, konstatimet tregojnë se **situata e përfshirjes së OSHC-ve në fushën e zhvillimit të kapitalit njerëzor ishte mjaft e qartë** dhe se mënyrat më efikase të zbatimit të aktiviteteve të tyre, si p.sh. kurset joformale të trajnimit, mbështetja e të mësuarit informal nga bashkëmoshatarët apo kolegët, të mësuarit autodidakt, etj. duke i motivuar njerëzit që të mësonin dhe duke përdorur një kombinim të mjeteve tradicionale dhe dixhitale të trajnimit ishin gjithashtu në përputhje me aktivitetet ku ato fokusoheshin.

Këto gjetje kanë qenë gjithashtu në përputhje edhe me ato të INSTAT “Anketë për arsimin e të rriturve e vitit 2017 për Shqipërinë” (INSTAT, 2017), ku theksohet se arsyeja kryesore për pjesëmarrje në trajnime dhe në arsimin joformal ishte përmirësimi i aftësive për punën në masën 54.7 %, pasuar nga rritja e njohurive me 39.1 %, si dhe përmirësimi i mundësive për karrierë me 38.2 %. Në lidhje me aksesin për informacione për mundësi të mësuarit dhe për orientime, i njëjti raport thekson se 8.2 % e popullatës së grupmoshës 25-64 ka kërkuar informacione për mundësi të mësuarit në vitin 2017. Femrat kanë qenë më aktive në kërkimin e informacionit për mundësi të mësuarit sesa meshkujt, përkatësisht 9.2 % dhe 7.3 % (INSTAT, 2017).

Pavarësisht sfidave me të cilat janë përballur OSHC-të në **vitin 2020 për shkak të pandemisë së COVID-19, vetëm pak prej tyre** i kanë ndryshuar **grupet përfituese të aktiviteteve.** Në vitin 2020,

krahasuar me vitet e mëparshme, OSHC-të raportuan se kanë punuar më shumë **për të mësuarin joformal për të rinjtë, për të forcuar të mësuarin informal për të rinjtë dhe për avokacinë për të rinjtë**. Në përputhje me këto tendenca, studimi raportoi **një rritje të aktiviteteve të reja në të njëjtat fusha**. Kjo ndoshta lidhet edhe me përdorimin e teknologjisë nga grupi i synuar i përfituesve për shkak të protokollit të distancimit social të vendosur nga qeveria (d.m.th. të rinjtë e përdorin më shumë teknologjinë dixhitale sesa grupmoshat e tjera). **89% e të anketuarve raportuan se i kishin përdorur më shumë mjetet dixhitale të të mësuarit gjatë pandemisë së COVID-19 në vitin 2020 krahasuar me vitet e mëparshme**.

Në lidhje me qëndresën e OSHC-ve, anketa tregoi disa karakteristika të sektorit të OSHC-ve, siç raportohet edhe në studime të tjera të ngjashme për Shqipërinë në vitin 2019. Kapacitetet menaxhuese dhe qëndrueshmëria financiare vazhdojnë të jenë dimensionet më të dobëta të qëndrueshmërisë⁹. Anketa jonë tregoi **se ishte një numër i kufizuar kapacitetesh të burimeve njerëzore të OSHC-ve që kishin vazhduar me staf dhe bashkëpunëtorë me pagesë, të cilët e kishin parë të vështirë mbajtjen e stafit permanent dhe me kohë të plotë**, për shkak të kufizimeve që lidhen me financimin në bazë projektesh ose me financimin nga donatorët. Përveç kësaj, OSHC-të në zonat rurale dhe në zonat periferike ishin përballur me vështirësi në thithjen e burimeve të kualifikuara njerëzore për shkak të emigracionit dhe shpopullimit të këtyre zonave. Në të njëjtën kohë, angazhimi vullnetar në Shqipëri vazhdon të jetë i ulët.

Bashkëpunimi me organizatat e tjera konsiderohej nga OSHC-të e anketuara si pjesë e përpjekjeve të tyre për qëndrueshmëri, porë në aplikimin dhe zbatimin e projekteve të përbashkëta brenda organizatave me mision dhe objekt të ngjashëm, si dhe në përfundimin e njohurive dhe përvojave nga organizatat më të zhvilluara, kryesisht në zonat urbane (sidomos në Tiranë). Mungesa e aktiviteteve dhe mbështetjes për rrjetëzimin dhe partneritetet; numri i kufizuar i programeve të shkëmbimit për të mësuar nga modelet e mira dhe praktikatat më të mira; vizitat studimore që mundësojnë avancimin e mëtejshëm të OSHC-ve, etj. shiheshin si disa prej nevojave të identifikuara nga OSHC-të.

Aksesi dhe pjesëmarrja e ulët në rrjetet rajonale dhe evropiane përfaqësonin nevoja që mbeten për t'u adresuar me synim forcimin institucional, forcimin e aftësive për mbledhje fondesh dhe për rritjen e vizibilitetit dhe marrëdhënieve publike me aktorët e tjerë. Nga OSHC-të e anketuara, vetëm njëra prej tyre operonte në nivel evropian.

Mësimet afatshkurtra të OSHC-ve dhe në masë të madhe edhe mësimet afatgjata, strategjike ose largpamëse të nxjerra nga zbatimi i aktiviteteve të ZHKNJ në përgjigje të krizës së pandemisë COVID-19 **tregoi qëndresën e OSHC-ve gjatë krizës së pandemisë së COVID-19 dhe përfshinin** (a) përshtatjen e zbatimit të aktiviteteve ose metodave të tyre, dhe (b) novacionin & ripriorizimin e shërbimeve ekzistuese, duke reflektuar mbi vlerësimin e tyre të brendshëm të nevojave dhe kërkesave nga përfituesit e tyre të synuar. Kjo kërkonte menaxhim të brendshëm dhe rritjen e kapaciteteve sa u përket burimeve të reja, njerëzore dhe/ose financiare dhe/ose fizike, rritjen e ekspertizës dhe ritrajnimit të anëtarëve të stafit dhe të vullnetarëve

Angazhimi dhe roli aktual i OSHC-ve, si dhe potenciali për të ardhmen zbuloi se COVID-19 ofroi jo vetëm sfida të mëdha, por edhe një mundësi të pazakontë për OSHC-të që të kontribuonin në ZHKNJ, duke pasur parasysh fleksibilitetin e tyre për t'u përshtatur dhe për t'u angazhuar me përfituesit e tyre. Ndonëse ishte **një numër i kufizuar** OSHC-sh të anketuara që raportuan se kishin qenë sistematikisht **të përfshira** në dialogun për politikatat në lidhje me të mësuarin joformal, të mësuarin informal dhe

⁹Indeksi i Qëndrueshmërisë së OSHC-ve (CSOSI) për Evropën Qendrore dhe Lindore dhe Euroazinë, Shqipëri 2019

punësimin, shumica e tyre **shprehën vullnetin** për t'u angazhuar në dialogun për këto politika. Pati një rol mjaft plotësues dhe bashkëpunues që OSHC-të përcaktuan se duhet të luajnë sidomos në lidhje me mbështetjen e ofruesve të shërbimeve të arsimit dhe trajnimit. Mund të dilet në përfundimin se shumica e OSHC-ve pjesëmarrëse në këtë anketë kanë mbështetur **OZhQ 5 “Barazia gjinore”, OZhQ 8 “Puna e denjë dhe rritja ekonomike”, dhe OZhQ 10 “Reduktimi i pabarazive”**. Ky rol specifik i OSHC-ve duhet të mbështetet dhe të vlerësohet më tej nga të gjithë aktorët. Tre OSHC të tjera shtuan edhe OZHQ 12, “Konsumi dhe Prodhimi i Përgjegjshëm” si një fushë të mbështetur prej tyre. Mbështetja e efikasitetit të proceseve të arsimit, trajnimit dhe proceseve të tjera të të mësuarit dhe përpjekjet për përmirësimin e rezultateve të dialogut mbi politikat dhe rezultatet e konsultimeve publike shiheshin si një **avantazh madhor i OSHC-ve krahasuar me aktorë të tjerë publikë, privatë dhe joqeveritarë**. Në perspektivë, **më shumë se 53% e OSHC-ve të anketuara planifikonin ta forconin kontributin e tyre në fushën e ZHKNJ** në lidhje me aksesueshmërinë e të mësuarit formal, joformal, informal, gjithëpërfshirjen, dhe cilësinë e mundësive të të mësuarit dhe plotësimit të nevojave të individëve për të mësuar dhe punësim.

REFERENCAT

Charities Aid Foundation, 2019. *CAF World Giving Index*. [Online]
Gjendet në: https://www.cafonline.org/docs/default-source/about-us-publications/caf_wgi_10th_edition_report_2712a_ëeb_101019.pdf
[vizituar më 8 dhjetor 2020].

INSTAT, 2017. *Anketa e Arsimit të të Rriturve*. [Online]
Gjendet në: <http://www.instat.gov.al/media/4028/adult-education-survey-2017.pdf>
[vizituar më 8 dhjetor 2020].

Partners Albania for Change and Development, 2019. *Capacity and Needs Assessment for CSOs in Albania*, Tirana: Partners Albania for Change and Development.

Partners Albania for Change and Development, 2019. *Monitoring Matrix on Enabling Environment for Civil Society Development, Country Report Albania*. [Online]
Gjendet në: <https://partnersalbania.org/publication/monitoring-matrix-on-enabling-environment-for-csos-development-country-report-for-albania-2019/>
[vizituar më 10 dhjetor 2020].

The Danish Institute for Human Rights, 2019. *SDG - Human Rights Data Explorer*. [Online]
Gjendet në: <https://sdgdata.humanrights.dk/en/node/1>
[vizituar më 10 dhjetor 2020].

USAID, 2019. *CSO Sustainability Index (CSOSI) for Central and Eastern Europe and Eurasia, Albania*. [Online]
Gjendet në: <https://idmalbania.org/csosi-usaid-report-for-albania/>
[vizituar më 10 dhjetor 2020].

1. Prezenca online e OSHC-ve të anketuara

Adresa e faqes së internetit (URL)

<http://www.fash.al/>
<http://www.sommelier.al/>
<https://albanianictacademy.com/>
https://cbtl-see.com/?fbclid=IëAR35CYxgNd3GfHMBLxehKXYRqËs_nVczQjIUxF_2l1ë0OMzERKkghPovVpc
<https://cyp.al/>
<https://irca.al/>
<https://nucleus.al/>
<https://qek.al/rreth-nesh.html>
<https://shum.al/>
https://www.facebook.com/Albanian-Center-for-Sustainable-Development-464322891054558/?tn-str=k*F
<https://www.icidalbania.org/>
<https://www.lrd-albania.org/>
<https://www.rcdcalbania.org/>
nccsalbania.ëordpress.com
Qendra Rinore e Vlores/Vlora Youth Center
www.albanianskills.org
www.apadi.org
www.icla.co

WWW.OMSALBANIA.ORG

Facebook

AlbanianSkills

<https://www.facebook.com/albanianictacademy>
<https://www.facebook.com/apadi.albania/?pageid=587082641359908&ftentidentifier=3254902671244545&padding=0>
<https://www.facebook.com/cbtlsee/>
<https://www.facebook.com/CenterOfDevelopmentAndSocialInitiatives>
<https://www.facebook.com/cyp.kukes>
<https://www.facebook.com/Euleus-221089978445611/>
<https://www.facebook.com/fashfanpage/>
<https://www.facebook.com/fcselenice>
<https://www.facebook.com/gruajanezhvillimkorce>
<https://www.facebook.com/ICID-Albania-265774886958720>
<https://www.facebook.com/InstituteForChangeAndLeadershipInAlbania>
<https://www.facebook.com/IRCA.AL>
<https://www.facebook.com/levizjarinore.puke.5>
<https://www.facebook.com/nccs.albania>
<https://www.facebook.com/nucleus.al/>
<https://www.facebook.com/OpenMindSpectrumAlbania>
<https://www.facebook.com/OrganizataShqiptareSommelierise>

<https://www.facebook.com/Qendra-Konsumatori-Shqiptar-Albanian-Consumer-Center-895987337113026>

<https://www.facebook.com/qendrabashkepertearthmen/>

<https://www.facebook.com/qendraperedukimkulinar>

<https://www.facebook.com/YDIPorganization>

<https://www.facebook.com/Youth-for-Social-Change-1155047071217681>

Shoqata e Ushqimit dhe Mirëqenies

Qendra Rinore e Vlorës

Instagram

@inlsh_icla

albanianictacademy

AlbanianSkills

<https://www.instagram.com/apadi.ngo/>

<https://www.instagram.com/explore/locations/863231901/fondacioni-arsimor-shqiptar/>

https://www.instagram.com/forumi_civil_selenice/

<https://www.instagram.com/gruajanezhvillimkorce/>

https://www.instagram.com/irca_albania/

<https://www.instagram.com/omsalbania/>

https://www.instagram.com/qek_kulinari/

https://www.instagram.com/qendra_konsumatori_shqiptar/

https://www.instagram.com/qpr_kukes/

<https://www.instagram.com/rbmt.al/>

https://www.instagram.com/sommelieria_shqiptare/

https://www.instagram.com/ydip_organisation/

<https://www.instagram.com/yscorg.al/>

Levizja Rinore Puke

Shumalbania

Linkedin

Shoqata Kombëtare për Garat e Aftësive Shqiptare

<https://www.linkedin.com/company/11806945/admin/>

<https://www.linkedin.com/company/nucleus-albania/>

<https://www.linkedin.com/company/regional-center-for-development-and-cooperation/?originalSubdomain=al>

<https://www.linkedin.com/in/open-mind-spectrum-albania-omsa-33a25119b/>

Qendra Rinore e Vlorës

[www.linkedin.com;groups;Institute-Change-Leadership-in-Albania-4008981?gid=4008981&trk=hb_side_g](https://www.linkedin.com/groups/Institute-Change-Leadership-in-Albania-4008981?gid=4008981&trk=hb_side_g)